

Termet e Referencës

Ekspert/e i/e Komunikimit – Phase 2. Solidarity in Action: Aleanca LGBTI's Stand Against Anti-Gender Movements

Aleanca LGBTI po zbaton Fazën II të projektit “Solidaritet në Veprim” (01/08/2025 – 31/03/2026) me mbështetjen e Kvinna till Kvinna. Projekti ndërton mbi arritjet e Fazës I, duke u fokusuar në forcimin e aleancave feministe dhe për të drejtat e njeriut, zgjerimin e shërbimeve për gratë LBT dhe avancimin e reformave ligjore. Një shtyllë qendrore e kësaj faze është **komunikimi strategjik**: informimi dhe qwndresa ndaj retorikave anti-gjinore, rritja e dukshmërisë së realiteteve të grave LBT, amplifikimi i narrativave të solidaritetit dhe sigurimi i avokimit me bazë prova përmes fushatave, aktiviteteve publike dhe angazhimit me median.

2. Qëllimi i Detyrës

Eksperti/ja i/e Komunikimit do të udhëheqë dhe zbatojë aspektet e komunikimit dhe dukshmërisë së iniciativës, duke siguruar që dezinformimi të kundërshtohet me narrativa të bazuara në fakte dhe që Aleanca dhe partnerët e saj të mbeten një prani e dukshme dhe e besueshme në sferën publike.

3. Përgjegjësitë Kryesore

Eksperti/ja i/e Komunikimit do të punojë ngushtë me Menaxheren e Projektit, Oficeren e Avokimit dhe Drejtoreshën Ekzekutive të Aleancës për të:

1. Komunikimi Strategjik & Planifikimi

- Zbatimi i planit të komunikimit dhe dukshmërisë hartuar në fazën e parë të nismës, në përputhje me kërkesat e Aleanca LGBTI.
- Formalizimi dhe zbatimi i protokolleve për reagim të shpejtë ndaj narrativave dezinformuese.
- Reflektimi i perspektivave feministe ndërsektoriale në të gjitha produktet e komunikimit.

2. Krijimi i Përmbajtjes & Fushatat

- Hartimi dhe shpërndarja e materialeve në lidhje me fushatat kundër gjuhës së urrejtjes, dezinformimit dhe dhunës me bazë gjinore ndaj grave LBT.
- Prodhuimi i produkteve multimediale (video, infografikë, postime në rrjete sociale, dëshmi personale) që nxjerrin në pah përvojat e jetuara të grave dhe vajzave LBT.

3. Angazhimi Publik & Rrjetëzimi

- Formalizimi i produkteve të komunikimit të Rrjetit Kundër Gjuhës së Urrejtjes, duke siguruar dukshmëri të përbashkët me partnerët (grupe LGBTI, organizata të grave, të drejtave të njeriut, grupe rinore, media të pavarura).
- Ruajtja e marrëdhënieve me gazetarë dhe redaktorë, duke promovuar raportim etik dhe gjithëpërfshirës.

4. Dukshmëria & Monitorimi i Medias

- Koordinimi i aktiviteteve publike dhe sensibilizuese (p.sh., fushata, aktivitete të lidhura me Tirana Pride, 8 Marsin dhe ndërgjegjësim mbi dhunën me bazë gjinore).
- Monitorimi i medias dhe hapësirave online për mbulimin e narrativave anti-gjinore.

4. Produktet e Pritshme

- Plan komunikimi dhe dukshmërie (Muaji 1).
- Kalendar mujor për përmbajtjen në rrjete sociale dhe fushata.
- Të paktën 3 fushata/deklarata të përbashkëta të Rrjetit Kundër Gjuhës së Urrejtjes.
- Minimumi 12 produkte digjitale (video të shkurtra, grafikë, tregime) gjatë periudhës së projektit.
- Kontribute për seksionin e komunikimit në raportet ndërmjetëse dhe përfundimtare të projektit.

5. Kohëzgjatja dhe Angazhimi

- Kohëzgjatja: Shtator 2025 – Mars 2026 (7 muaj).

6. Raportimi dhe Mbikëqyrja

Eksperti/ja i/e Komunikimit do t'i raportojë Menaxheres së Projektit dhe do të punojë nën udhëzimin e Drejtoreshës Ekzekutive të Aleancës, në bashkëpunim të ngushtë me Oficeren e Avokimit dhe stafin e projektit.

7. Kualifikimet dhe Përvoja

- Diplomë universitare në komunikim, gazetari, media, marrëdhënie me publikun ose fusha të ngjashme.
- Të paktën 3 vite përvojë profesionale në komunikim dhe fushata.
- Eksperiencë e fortë në menaxhimin e rrjeteve sociale, krijimin e përmbajtjes multimediale dhe strategjitë e fushatave.
- Njohuri mbi të drejtat e njeriut, barazinë gjinore dhe çështjet LGBTIQ+ në Shqipëri dhe rajon.
- Përvojë në kundërshtimin e dezinformimit dhe ndërtimin e narrativave është përparësi.
- Aftësi të shkëlqyera në të shkruar dhe komunikuar në gjuhën shqipe dhe angleze.

8. Parime Etike

Eksperti/ja duhet të respektojë vlerat e Aleancës për barazi, dinjitet dhe mosdiskriminim, duke ruajtur konfidencialitetin dhe sigurinë e të gjithë përfituesve dhe partnerëve.

9. Procedura e Aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë në adresën e emailit aleanca.al@gmail.com, brenda datës 15 Shtator 2025:

- CV (maksimumi 3 faqe)
- Letër motivimi që tregon përvojën përkatëse
- Portofol ose shembuj të punëve të mëparshme në komunikim dhe fushata